

**MERITA SAUKU BRUCI**

**AUTORË DHE LETËRSI ARBËRESHE  
NË PROGRAMET E SISTEMIT PARAUNIVERSITAR:  
PROBLEME DHE PROPOZIME**

*Nga qielli i poetëve, i florinjhtë, i paanë,  
De Rada dhe Serembe thërrasin të vëllanë  
Françeskun, që studiuesit, e menduar pedantë,  
S'guxuan atyre t'ia vendosin pranë.*

Klara Kodra<sup>1</sup>

Lënda e letërsisë shqipe zhvillohet, sipas programit të aprovuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë në 2 orë x 35 javë. Studiumit të romantizmit dhe Jeronim de Radës i kushtohen 6 orë. Qëllimi ynë: të qëmtojmë cili është raporti me të vërtetën autoriale dhe tekstore të autorëve dhe teksteve të përdorura për të ilustruar e analizuar prodhimtarinë letrare të përfaqësuesve arbëreshë të periudhës së romantizmit, e pasqyruar në programet e librat e klasës së 11. Analizës sonë i nënshtrohen disa botime, duke paramenduar të mirëqenë një situatë normale përgatitjesh për botim, që nënkupton respektim të afateve të duhura kohore në fushën e hartimit të programeve dhe teksteve. Kemi zgjedhur të bëjmë një prerje sinkronike duke marrë në shqyrtim 4 tekste të nxënësit e të mësuesit në qarkullim e përdorim në vitet mësimorë 2017-2018 dhe 2018-2019, të cilat për lehtësi citimi do t'i paraqesim më poshtë me siglën përkatëse dhe faqen nga janë marrë citimet. Për librat e mësuesit kemi shqyrtuar botimet e tyre *në rrjet*<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Klara Kodra, *Thirrje*, poezi kushtuar F. A. Santorit, botuar në gazetën *Nacional* më 19.01.2020.

<sup>2</sup> [Pegi] [https://shkollaime.al/pluginfile.php/29/mod\\_page/content/74/Liber%20mesuesi%20Letersia%2011.pdf](https://shkollaime.al/pluginfile.php/29/mod_page/content/74/Liber%20mesuesi%20Letersia%2011.pdf);

[AL]: Ardian Marashi, Sabri Hamiti, Dhurata Shehri *Letërsia 11*, botime shkollore **Albas**, 2017 si edhe

[LMAL]: Aleksandra Janaqi, Evelina Doka, **Libri i mësuesit për tekstin shkollor**, 2017.

[FI]: Zhuljeta Stringa, Valbona Kalo, Migena Kapllani, Marsela Neni, Merita Balliçi, *Letërsia 11, Filara*, 2017.

[LMFI]: Safinas Boksi (Boriçi), *Libri i Mësuesit, Letërsia 11*, Shtëpia botuese e shtypshkronja **Filara**, 2017.

[PE]: Ymer Çiraku, Irena Ndoci, Adriatike Lami, Elsa Skënderi, *Letërsia 11* për arsimin e mesëm të përgjithshëm, Tiranë, PEGI, Viti i botimit:?

[SHR] Jorgji Doksani, Oriana Osmani *Letërsia 11*, SHBLSH E RE, Viti i botimit 2016

[SHRLM] Oriana Osmani, Anila Shahu, *Libri i mësuesit*:

***Problematikat që hasim:***

Letërsia arbëreshe e shekullit XIX duket si një krijimtari e mbyllur nga pikëpamja e shtrirjes kohore por studimet e reja që dalin apo zbulimet e dorëshkrimeve të shkrimtarëve bëjnë që dija mbi këta autorë e veprat e tyre të mbetet në përditësim. Në mungesë të këtij përditësimi nga ana e hartuesve të teksteve gjejmë edhe informacione të vjetruara që bien ndesh me të vërtetën, apo kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Le të shohim më në veçanti se ç'njohuri marrin parauniversitarët sot lidhur me fillesat e lëvrimin të romanit apo të dramës në letërsinë shqipe. Sa i takon lëvrimin të romanit hartuesit e teksteve rreshtojnë Sami Frashërin, Pashko Vasën dhe Ndoc Nikajn<sup>3</sup>.

---

[Albas] <https://albas.al/botime/liber-mesuesi-per-tekstin-shkollor-letersia-11/>;

[Filara] <https://filarabotime.com/product/libri-i-mesuesit-letersi-11/>

[SHBLSH E RE]

<https://www.albanianeducation.com/wp-content/uploads/2017/07/letersia-11-libri-i-mesuesit-final.pdf>

<sup>3</sup> “Romani, si forma më e madhe letrare, u krijua nga S. Frashëri (*Dashuria e Talatit me Fitneten*, shkruar në turqisht ) dhe nga Pashko Vasa (*Bardha e Temalit*, shkruar në frëngjisht)” [AL, 88]; “Romani, si lloji më i madh letrar u lëvrua nga Sami Frashëri (*Dashuria e Talatit me Fitneten*) e shkruar në turqisht- dhe Pashko Vasa (*Bardha e Temalit*) e shkruar në frëngjisht.” [FI,

Është e dukshme që si burim informacioni për hartuesit e teksteve është një histori letërsie e vjetruar ose përcillet një informacion i gatshëm dhe i mirëqenë nga një tekst tek tjetri. Në mungesë të një historie letërsie më të përditësuar, një kërkim i thjeshtë në internet apo në shtypin e shkruar do t'u mundësonte të dhënat e duhura se që prej vitit 2011 ekziston dhe është botuar, nga zbulimi i dorëshkrimeve, romani i parë inaugurues i kësaj gjinie letrare, i lëvruar për më tepër në gjuhën shqipe, me titull “*Sofia e Kominiatëve*” vepër e hartuar nga F. A. Santori<sup>4</sup>. Këtu nuk janë përfshirë as romanet e Santorit të shkruara në italishte. A thua kjo vjen nga mosnjohja e vetë prodhimit letrare të pamasë të Santorit dhe të peshës specifike që ai zë në trashëgiminë tonë letrare<sup>5</sup>? Mendojmë se po. Ndryshe nuk do të hasnim konsiderata të rralla, të cekta në rastin më të mirë<sup>6</sup> apo

---

68]”; “Në letërsinë shqipe romani është zhvilluar vonë. Romancieri i parë është Ndoc Nikaj “Shkodra e rrethuese”. [FI,10]

<sup>4</sup> Francesco Antonio Santori, *Sofia e Kominiatëve – Editio Princeps*, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino. Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku-Bruçi, Vol. I, Università degli Studi di Napoli L’*Orientale*, Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, Napoli, 2011.

<sup>5</sup> Bashkëkohës i De Radës Françisk Anton Santori (1819-1894) të befason me gjerësinë e krijimtarisë së tij, me shumëllojshmërinë e gjinive letrare që lëvron: dramë, melodramë, satirë, komedi, tragjedi, novela në vargje, roman, fabulistikë, rapsodi. Ai madje mund të quhet edhe më prodhimtari i letërsisë arbëreshe dhe themeluesi i disa llojeve e gjinive të letërsisë sonë: i dramës në vargje e në prozë, i satirës, i fabulës e i romanit. Shih për më shumë: Merita Sauku Bruçi: “Vendi i munguar i Françisk Anton Santorit në letërsinë shqipe (Françisk Anton Santori’s rightful place in the Albanian literature) në *ANAS, Studia humanitatis*, 7-8, Shkup, Botim i Institutit ALB-SHKENCA, 2014, f. 29-42. Universiteti i Kalabrisë ka hedhur në rrjet një botim a ribotim elektronik të disa veprave me karakter fetar e letrar të Santorit të përgatitur nga Vincenzo Belmonte. Shih:

<http://www.albanologia.unical.it/FrancescoAntonioSantori/opere.html>

<sup>6</sup> “Në letërsinë romantike shqiptare drama u shfaq me *Sofonizbën* e De Radës, *Emirën* e Santorit dhe *Besën* e Sami Frashërit.” [AL, 88]; “Anton Santori (1819-1894) shkroi dramën shpirtërore e shoqërore të arbëreshëve. Drama *Emira* mbahet si e para dramë e njohur në gjuhën shqipe.” [AL, 84]; “Ndërsa Santori krijoi forma poetike rrefimtare në vargje, që shkojnë nga romanca apo novella.” [AL, 87]; “Anton Santori shkruan dramën “Emira”. [SHR, f. 121]; “Tek arbëreshët e Italisë, përveç Jeronim de Radës, shquhet Anton

mospërfshirje në programe në rastin më të keq dhe mospërmendje në këto tekste<sup>7</sup>.

***Çfarë ndodh me autorët e cituar?***

Do ta fillonim shqyrtimin e problematikave të hasura më së pari me përzgjedhjen e teksteve të sjella për ilustrim e analizë. Ajo që vihet dukshëm re, në një kalim të kujdesshëm të të gjithë teksteve, është se autorët e kapitujve të ndryshëm kanë qenë korrektë të citojnë më së paku përkthyesit e fragmenteve ilustruese apo në rastin më të mirë edhe shtëpinë botuese, vitin e botimit si edhe numrin e faqeve nga janë marrë<sup>8</sup>. Pra modeli ekzistua. Po përse për tekstet që merren për ilustrim nga krijimtaria e autorëve arbëreshë ky rregull nuk ndiqet fare në rastin më të keq duke bërë të pamundur gjurmueshmërinë e gabimit<sup>9</sup> apo citohet vetëm përshtatësi në rastin më të mirë. Kjo vihet re në të gjitha botimet e marra në shqyrtim. Jo vetëm kaq: janë përdorur tekste, që për komunitetin shkencor dhe në vijimësi për cilindo që këto tekste i përdor në programe mësimore universitare e parauniversitare, janë filologjikisht të papranueshme dhe larg vullnetit të autorëve.

Santori, Zef Serembe, Dara i Riu, Zef Skiroi, etj.” [SHR, 121]; “Autorët e saj më kryesorë janë Jeronim de Rada, Gavril Dara, Zef Serembe. Zef Skiroi, (dhe i fundit në radhë - MB) Santori.” [AL, 88]

<sup>7</sup> F. A. Santori nuk citohet as tek autorët më përfaqësues të Rilindjes Kombëtare. I padenjë apo jo aq i talentuar sa për t’u radhitur krahas tyre? Tek [PE,107, 108] përmendet vetëm De Rada, Serembe dhe Skiroi.

“Disa nga autorët më përfaqësues të asaj (letërsisë romantike arbëreshe) janë talentë të nivelit evropian si Jeronim de Rada, Zef Serembe, Gavril Dara dhe Zef Skiroi.” [FI, 70]

<sup>8</sup> Citohen saktësisht përkthyesit e autorëve Gëte [SHR, 90-91; PE, 49; FI, 25-26], Leopardi [AL, 18], Bajron [FI, 58] Hygo [PE,73], Balzak [SHR, 167; PE, 155, AL, 158], Flober [SHR, 176, AL, 175]; Tolstoi [AL,141], Dostojevski [SHR, 184; PE,189; AL, 201], Bodler [PE, 226, AL, 223; FI, 173]. Për t’u vënë re ngatërrimi i autorësisë së përkthimit të Ardian Marashit për përkthimin e Bodlerit [SHR, 197]. Informacionin më të saktë, që përmban emrin e përkthyesit, shtëpinë botuese si edhe faqet gjegjëse e jep botimi i shtëpisë botuese PEGI me hartuese Irena Ndoci Lama. Gjithçka mbetet në duart e hartuesve pasi brenda librit të së njëjtës shtëpi botuese gjejmë modele të ndryshme citimi.

<sup>9</sup> [SHR, 128-129; FI, 193]

*Tjetërsimi i vargjeve të Serembes*

Serembe është një autor problematik në autenticitetin e veprës që ka lënë. Hartuesit e tekstit e kanë për detyrë të cilësojnë më së paku nga i kanë marrë këto vargje, kush i ka përshtatur, nga cili botim, i cilit vit, nga cila antologji. Bëhet fjalë për një nxitim apo një zgjedhje të mirëmenduar të autorëve? Në rubrikën *Autorë dhe vepra - Lexime të komentuara* të [AL,91] është përzgjedhur poezia *Elegji* e Zef Serembes. Leximi filologjik i 39 vargjeve të poezisë së supozuar të autorit Serembe na sjell para syve një tekst të tjetërsuar si në formën gjuhësore të paraqitur, standarde, ashtu edhe në përmbajtjen e saj. Po shkëpusim 6 vargje prej saj dhe po bëjmë një përpjekje për të kuptuar se nga cili botim mund të jetë shkëputur ky fragment duke konsultuar botimin më të parë të saj në shqip nga Cosmo Serembe më 1926<sup>10</sup>:

**Serembe i supozuar [AL, 92]**

Oh, po të puthja atë buzmerxhane,  
Dhe ata sy si yje, dhe atë ballë  
Të ëmbël posi rrezja  
E qiellit të zbukuruar,  
ku mbijnë dhe rriten  
të gjithë shpresat tona!

**Cosmo Serembe, 1926, f. 104**

O ndë puthsha atë buzkuraljë  
E ata syë si yljë, e atë baalë  
E ëmbëljeze posi rrëmbi  
Të qiellit i zbukuruarë  
Ku mbihen edhe rryten  
Të gjitha shpërsat t'oonë!

Më i saktë gjuhësisht dhe në respekt të vullnetit të autorit konsiderohet botimi kritik i teksteve të këngëve nga dorëshkrimet që gjenden në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagenit, realizuar nga Gradilone<sup>11</sup>. Fragmenti gjegjës bën pjesë në gjashtë vargjet përmbyllëse të poezisë me titull *Vjershe*.

---

<sup>10</sup> Shih: Giuseppe Serembe, *Vjershe*, a cura, con prefazione e note dell'avv. Cosmo Serembe, Milano, Società Tipografica italiana Grandi Edizioni, 1926. Poema *Eledçië* përmban tri pjesë me 200 vargje gjithsej. Filologjikisht ky botim quhet i tejkualuar, i manipuluar dhe për pasojë i pasigurt për t'iu referuar. Megjithatë kemi qëmtuar vargjet gjegjëse që gjenden në f. 62 të botimit.

<sup>11</sup> Shih: Giuseppe Gradilone, *Contributo alla critica del testo dei canti di Giuseppe Serembe*, testi dei canti, Kopenhagen, Gradilone, botim kritik,

Oh! Vet të të puthja ahier at buz-kuraal  
 Me ata sii po si iil, me at ballë si rrëmb  
 djamanti qielli e pra mbjatu mbi mua  
 Vëdekjes të m'fjantaksej sqepi vrërë  
 Se u gjith helmet harruor, me një gaz ndë buz  
 Ruoja, si dielli çë hinë, gjellen çë vej.

Këto gjashtë vargje përmyllin edhe botimin më të parë të kësaj poezie të gjatë përkthyer në italishte nga vetë Serembe<sup>12</sup>:

Nga Serembe janë paraqitur edhe vargje nga poezia “Detari” dhe “Vrull”<sup>13</sup> në botimin e *Filara-s* reflektojnë të njëjtën shmangie nga gjuha e autorit, referim nga një botim i dyshimtë. Një nismë e brishtë për të pasqyruar Seremben në origjinal na vjen nga *Albas* me poezinë *Te bregu i detit*<sup>14</sup>. Poezia me gjasë është marrë nga botimi i Cosmo Serembes dhe përveç pasigurisë që ky botim ofron, atij i mbivendosen edhe gabimet filologjike të hartuesve të tekstit.

*Gavril Dara i tjetërsuar*

---

Roma 1989. Poezia me titull *Vjershe [I]* përmban 37 vargje dhe gjendet në f. 105 të këtij botimi.

<sup>12</sup> *Poesie italiane e canti originali tradotti dall'albanese in italiano per Giuseppe Serembe, Cosenza, Tipografia dell' Avanguardia, 1883. Poezia prej 126 vargjesh titullohet *Elegia. Al Cugino Giovanni Andrea Prof. Vinacci in memoria affettuosissima*, gjendet në faqet 110-104 të këtij botimi. Fragmenti ynë i takon f. 104.*

Oh! Che ti baciassi quella bocca di corallo  
 Con quegli occhi limpidi di stella, e quella fronte  
 Soave come un raggio di cielo scoperto dove  
 Con amore nascono e germogliano tutte le speranze!  
 E non curerei se allora  
 Di morte m'apparisse il nero velo;  
 Perchè io dimenticando tutti i dolori,  
 Guarderei, col sorriso nella bocca,  
 Come il sol che tramonta la vita fuggitiva.

<sup>13</sup> Shih [FI, 67 si edhe 71]

<sup>14</sup> Shih [AI, 235]

Nuk shpëton nga kjo as poema *Kënga e sprasëme e Ballës*, për të cilën shfaqen të njëjtat probleme që fare mirë mund të davariteshin nëse hartuesit e teksteve do të merrnin mundimin të kërkonin botimet kritike të këtyre teksteve, prej vitesh në qarkullim<sup>15</sup>. Kemi përzgjedhur më poshtë 10 nga 35 vargjet pjesë e këngës së parë të përdorur si ilustrim në botimin e *Albas*, pa cituar se nga janë marrë këto vargje.

[M. Mandala, 2007, f. 83]

Mori Bilj, bilj e Ljaljës,  
Mori e bukurëz, e mbriturëz  
Pse më siell ndë mōn shkuam?  
Njo, mjegulla e errët  
Rogomiset malj, malj;  
Diellit ljër maljit Gropës  
Tundet, qesh' shpati i humbët;  
Po, si tī, i bardh, i thjellët  
Sqepi i qiellit të reshtet  
Me një rreth të pa-sosur  
I rrimët, si ninëza e jote.

[AL, 92]

Mori bijë, bijë e Lalës  
Moj e bukur e trishtuar  
Pse m' kujton motin e shkuar.  
Ja, ku mjegulla e errët  
Rrokulliset mal më mal  
Sa lind dielli malit t' Gropës  
Tundet, qesh i thelli shpat.  
Porsi ti, e bardhë, e kthjellët  
Cipëza e qielli shtrihet  
me një rreth-o të pasosur  
E rimët, si ninëza jote.

*Edhe De Rada në kurthin e tjetërsimit*

Jeronim de Rada është më i studiuar, më i botuari në mënyrë kritike<sup>16</sup>, por edhe më i përshtatur në shqipen e sotme ndër autorët

---

<sup>15</sup> Shih: Gavril Dara (I Riu), *Kënga e sprasme e Balës* – transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme nga Shaban Demiraj, Prishtinë, botime ASHAK, 2006. Gabriele Dara junior, *Kënga e sprasëme e Ballës (Il canto ultimo di Bala)* - Edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Palazzo Ardiano, 2007.

<sup>16</sup> Sjellim në vëmendje botimin kritik më të fundit të veprës letrare të De Radës, në 6 vëllime, i botuar me financimin e Ministrive të Kulturës të Republikave të Shqipërisë dhe Kosovës në kuadrin e kremtimeve për “Vitin Deradian” me rastin e Dyqindvjetorit të lindjes së Jeronim de Radës (1814-

arbëreshë. Kështu edhe në programet shkollore është autori i vetëm që studiohet gjerësisht si përfaqësues i periudhës së romantizmit. Përzgjedhja e teksteve ilustruese mbi të cilat mbështetet i gjithë aparati analizues dhe komentues që e shoqëron, në katër botimet e sipërpërmendura, bie mbi poemën “Këngët e Milosaos” kryesisht por nuk mungon edhe poema “Serafina Topia”. Disa botime kritike janë të realizuara e megjithatë pak ose aspak janë marrë parasysh. Ndër problematikat që vihen re mund të radhisim:

- Pamundësi për të kuptuar nga cilat botime janë marrë, cilat burime janë shfrytëzuar<sup>17</sup>

- Këngët dhe fragmentet e vargjeve të përdorura për ilustrim janë thuajse të gjitha të përshtatura. Përshtatësi i tyre, jo gjithmonë i cituar, merr një rol të dorës së parë duke shmangur edhe vetë autorin; shpjegimet e fjalëve bëhen mbi zgjedhjet e përshtatësit<sup>18</sup>.

---

2014). Shih: Jeronim de Rada, *Vepra letrare*, Tiranë, Fondacioni “Francesco Solano” – MKRSH – MKRK, 2014.

<sup>17</sup> Botimi i [SHR,128-129] nuk jep asnjë informacion. Botimet e tjera japin informacion të shkurtër mbi tri botimet (1836, 1847 dhe 1873), f. 113, por jo nga cili botim janë marrë këngët apo vargjet për ilustrim [PE,113; FI,74, AL, 98]

<sup>18</sup> Botimi i SHBLSH E RE jep këngën e I, II dhe XXX vetëm të përshtatura. Nuk bëhet e ditur se nga janë marrë dhe kush i përshtati. Shpjegimet e fjalëve bëhen duke u nisur nga varianti i përshtatur. [SHR,128-129]

Botimi *Filara-s* paraqet këngën II, XII, XXII dhe XXX, të gjitha të përshtatura me gjasë nga Dhimitër Shuteriqit, pasi ky informacion rezulton vetëm për këngën XII [FI, 80]. Nuk ka informacion nga cili botim janë marrë. Botimi i *Albas* paraqet këngën I,V fragmente nga këngët VI, VIII, XX, XXX nën përshtatjen e Dhimitër Shuteriqit. Shpjegimet e fjalëve bëhen duke u nisur nga varianti i përshtatur. Saktësojmë se për këngën e parë dhe të pestë është paraqitur në dy kolona, e para në anën e majtë variant i përshtatur, dhe djathtas origjinal, por pa cituar botimin nga është marrë [AL,102, 104].

Botimi i *Pegi-t* ndryshe nga të tjerët vendos në qendër të vëmendjes së nxënësit botimin në origjinal. Vendoset e para në anën e majtë varianti origjinal, dhe djathtas i përshtatur. Nuk citohet nga është marrë variant origjinal për tri këngët: I, XII, XXX. Me gjasë përshtatësi në gjuhën e sotme është Ziaudin Kodra sipas pohimit të hartuesve të tekstit [PE,117] por një foto ilustruese vë në pah një botim të transliteruar nga Gjergj Zheji. Shpjegimet e fjalëve bëhen duke u nisur nga varianti i përshtatur.

- Edhe në rastet kur varianti origjinal është paraqitur, por pa u saktësuar nga është marrë, ai jepet më shumë si një kuriozitet letrar a gjuhësor<sup>19</sup> ose si rast ushtrimor për një lexim shprehës<sup>20</sup> dhe shumë rrallë përbën bazën tekstore mbi të cilën zhvillohen analizat. Vetëkuptohet që kërkesa të tilla si: reflektoni për metrikën, sintaksën poetike janë vështirësisht të realizueshme nga nxënësit të lënë të vetëm dhe të orientuar keq në përpjekjet e tyre.

Të marrim në shqyrtim 5 vargjet e para të kagjeljit (këngës) të parë:<sup>21</sup>

**De Rada, 1836<sup>22</sup>**

Ljis jeta kishë ndërruar

Uj të rī ndë dejtīt

Kaljtħëruar te dit' e rē.

Por llumbārdh e Anakreontit

Rronej Tēmp e moçēme.

**[AL, 102; PE, 115; SHR, 128]**

Bota kish ndërruar lisa

Uji i ri në det

Kaltëronte n'ditri' e re;

Por lumbardha e Anakreontit

Në Temp rronte e moçme.

A thua se ripërtëritja e natyrës do të ishte më pak e fuqishme në origjinal, për të justifikuar përdorimin e variantit të përshtatur? Çfarë e bën më të vështirë për ta kuptuar atmosferën e vargjeve të para të këngës II në arbërisht për t'ia bërë të pamundur nxënësve t'i shijojnë ato në origjinal, pa ndërmjetësinë e përshtatësit?

---

<sup>19</sup> “Hulumtoni për variantin arbërisht të poemës. Përpikuni të gjeni dallimet mes dialektit arbëresh dhe standardit të gjuhës shqipe.” [SHR, 128] “Krahasoni në aspektin gjuhësor variantin e përshtatur të këngës XXII me atë origjinal, të shkruar nga De Rada në arbërishten e kohës së tij. Renditni disa dallime fonetike, morfologjike dhe leksikore.” [FI, 84]

<sup>20</sup> “Lexim shprehës. Pasi të keni punuar me fjalorin, mësoni të lexoni variantin origjinal. Fillimisht shqiptoni fjalët më të vështira. Pastaj lexojeni të gjithë këngën duke respektuar ngjyresat e së folmes arbëreshe. Është shumë e rëndësishme kjo stërvitje, veçanërisht për t'u bërë aktorë të zotë në teatrin e shkollës”. [AL,106]

<sup>21</sup> Transkriptimet e vargjeve në origjinal janë tonat. Për më shumë konsultoni sitin ku janë të paraqitura botimet origjinale të De Radës [http://www.albanologia.unical.it/GirolamoDeRada/biblioteca\\_deradiana.html](http://www.albanologia.unical.it/GirolamoDeRada/biblioteca_deradiana.html)

<sup>22</sup> Fragmenti është marrë nga botimi i parë i Këngëve të Milosaos: *Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao figlio del despota di Scutari. Napoli, Da' tipi del Guttenberg, 1836*. Ai i takon vargjeve hyrëse të këngës së parë (kagjelji I) dhe ndodhet në f.14 të këtij botimi.

**De Rada, 1936, f. 16**

Vreshtat in të verdhullore  
 Erth ka malji dheljpëra  
 Me të ljothta të biljat  
 Porsa paru inë të vjelja.  
 E te ghera që ndër sheshet  
 Sqepet dielli si te bota  
 Ema që këntuan një valle  
 Vet Fjokat u m'u hjimisa

**Shuteriqi [FI, 78; SHR, 129]**

Vreshtat ishin verdhëllore  
 Erdh nga mali dheljpëra  
 Me të lodhura të bijat  
 Me të mbaruar të vjelat  
 E at'here kur te sheshet  
 fshihet dielli (si nën tokë)  
 mëmat që kënduan në valle  
 kur në Fjokat unë rashë.

Po sikur të gabohej edhe përshtatësi e t'i largohej frymëzimit dhe imazhit të realizuar nga autori? Le të shohim rastin e mëposhtëm nga kënga XII ku përshtatësi ka keqkuptuar vargun *nëng ruan më se anin* duke mos realizuar krahasimin e dhënë nga De Rada: ashtu si vala e detit, e turbullt si një mal, përqendrohet të godasë veç anijen ashtu edhe gratë në bisedat e tyre të përditshme nuk flasin veçse për dashurinë e birit të zonjës së madhe me vajzë e varfër, Rinën<sup>23</sup>.

**De Rada, 1836, f. 43-44.**

Si suvalj ndë dejt  
 Paru e trubull si një mal  
 nëng ruan më se anin  
 ashtu grāt ndo ven në krua  
 ndo te ljumi o për të gholla  
 mose thoin vashën e nëmur  
 që i bir' i Zonjës madhe  
 I dashur ziljepsunith

**Shuteriqi [FI, 80]**

Si suvala e detit  
 E turbullt, e si një mal  
 Nuk pyet më për anijen,  
 ashtu dhe gratë në krua,  
 o te lumi, o per shkarpa  
 flasin për çupën e varfër  
 që i biri i zonjës madhe  
 e don edhe dashurohet,

Në botimin e *Albas*, në rubrikën lexoni dhe komentoni, gjejmë edhe një fragment të titulluar *Këngë e Serafinës*. Megjithëse burimi nga është marrë dhe përshtatësi nuk janë cilësuar, shfletimi i tri

<sup>23</sup> Vetë De Rada na vjen në ndihmë me përkthimin e tij: "Com'onda torpida e gonfia che par montagna vien da tutti i lati del mare contro la nave, né altro cura, così le donne alla fontana, al fiume o per frache non dicean che della giovin borghese ch'ama ed è amata dal figlio della grande signora. Po aty. f. 43.

botimeve të kësaj poeme (1839, 1843, 1898) na mundëson të përcaktojmë se fragmenti i takon botimit të tretë dhe më të fundit në gjallje të autorit më 1898<sup>24</sup>.

**De Rada, 1898, f. 25-26**

Frammento d'una ode di Serafina.  
Ishim vasha buljëresha  
Tek zalli in e bridhënjim  
Vet nka Hjimara e ardhur  
Ndë javet me ljmësh ndë gjt  
Pa gëzim e ndo përrëz  
Së bardhes suvålj edhe  
Se puhjís më shkrepënej buzen  
Stivoo-dritem një aní  
Ka naljti me Bozdarin  
Vinej, njër çe të përjerra  
Atej gjith gjegjëtim jôn  
Çë ghumbej e prana ngrëghej  
Te djepet e dejtít

**[AL, 97]**

Këngë e Serafinës  
Ishim vasha buljaresha  
dhe tek bredhërinim.  
Unë, nga Himara e ardhur  
me lëmsh në gjí atë javë  
gëzim s'kisha, ndonse pranë  
shkumëbardhës valë, e buzët  
nga puhiza plasaritur.  
Velandritur një anije  
nga larg me Bozdarin vinte.  
gjer në çast kur bëri kthesën  
gjithë dëgjuam një këngë,  
që humbiste e ngrihej papë  
përmbi djep të valëve.

***Çfarë rrezikojmë kur u servirim nxënësve një tekst të përshtatur, për pasojë të tjetërsuar?***

A bie ndesh kjo zgjedhje me kompetencat lëndore të synuara dhe vlerat e mëtuarra në edukimin gjuhësor e letrar të nxënësve të sistemit parauniversitar?

Mendojmë se po. Në një vështrim më të gjerë nxënësit edukohen me vlera të cunguara në drejtim të respektimit të trashëgimisë kulturore dhe artistike të popullit tonë si edhe me

---

<sup>24</sup> Botimin më të parë kjo vepër e De Radës e njohu më 1939 me titull: *Canti Storici Albanesi di Serafina Topia Moglie del Principe Nicola Ducagino. Tradotti in prosa italiana*, Napoli, Tipografia Bolziana, 1839, 64 f. Ai ndiqet nga një botim i dytë, katër vite më pas me titull: *Poema Albanese volto in italiano per Girolamo De Rada. Canti di Serafina Thopia, Principessa di Zadrina nel secolo XV*, Napoli, Dallo stabilimento tipografico di Domenico Capasso, 1843, 67 f. Vepra njohu edhe një botim të tretë dhe të fundit me titull: *Poesie albanesi. Volume II. Uno specchio d'umano transito*, Napoli, Tipografia editrice F. di Gennaro e A Morano, 1898, 137 f.

gjykime të përcipta rreth kontekstit historik, kulturor e gjuhësor në të cilin është shkruar një tekst. Më ngushtësisht, në kuadër të përfimit të kompetencave lëndore lidhur me analizën dhe interpretimin e teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, nxënësve u bëhet e pamundur të analizojnë dhe interpretojnë elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik, si: motivet kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës etj.

Një seri stepjes, refuzimesh a pamundësish për të shkuar më larg e më thellë në kërkime nga ana e autorëve hartues të rubrikave përkatëse të këtyre teksteve të letërsisë, e redaktorëve shkencorë të pajtuar nga shtëpitë botuese, e më pas të mësuesve që janë të detyruar të punojnë me to kanë prodhuar një largim nga kjo trashëgimi e vyer arbëreshe që ne kemi dhe një pamundësi për ta shijuar atë në variantin original në të cilin është hartuar.

### ***Përfundime dhe propozime***

E gjitha sillet rreth edukimit gjuhësor edhe letrar. Ky është një proces që fillon që me përgatitjen e fidanishtes së mësuesve, pra në universitete, me dije të qëndrueshme gjuhësore e letrare e deri në përcimin e saktë të tyre tek nxënësit e studentët. Sot qarkullojnë shumë botime kritike dhe vullnetmira të autorëve arbëreshë, por zgjedhja e autorëve hartues duhet domosdoshmërisht të bjerë mbi tekstet që ofrojnë garancinë shkencore në respektimin e vullnetit të autorit: ato kritike. Mënyra e paraqitjes së teksteve ilustruese të përshtatura në shqipen standarde është jo shkencore, e dëmshme, e padrejtë, e tejkaluar tanimë dhe duhet evituar. Edhe nisma për t'iu pranëvënë teksteve të përshtatura ato në origjinal, në ndonjë botim, mbetet e diskutueshme për nga saktësia, e brishtë dhe e mënjanuar në kufijtë e kuriozitetit. Rruga më e saktë shkencërisht, më e drejtë, mbetet ajo e paraqitjes së një teksti të vetëm në origjinal të pajisur me shënimet shpjeguese ose me një paraqitje të zgjeruar në prozë të fragmentit të zgjedhur. Kjo zgjidhje nuk cenon vullnetin e autorit por lehtëson përcimin e kumtit të tij tek nxënësi.

## BIBLIOGRAFI

- Canti Storici Albanesi di Serafina Topia Moglie del Principe Nicola Ducagino. Tradotti in prosa italiana*, Napoli, Tipografia Bolziana, 1839, 64
- Dara (I Riu), Gavril, *Kënga e sprasme e Balës* – transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme nga Shaban Demiraj, Prishtinë, botime ASHAK, 2006.
- Dara junior, Gabriele, *Kënga e sprasëme e Ballës (Il canto ultimo di Bala)* - Edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Palazzo Ardiano, 2007.
- De Rada, Jeronim, *Vepra letrare*, Tiranë, Fondacioni “Francesco Solano” – MKRSH – MKRK, 2014.
- Gradilone, Giuseppe, *Contributo alla critica del testo dei canti di Giuseppe Serembe*, testi dei canti, Copenhagen, Gradilone, botim kritik, Roma 1989.
- Poesie italiane e canti originali tradotti dall’albanese in italiano per Giuseppe Serembe*, Cosenza, Tipografia dell’ Avanguardia, 1883.
- Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao figlio del despota di Scutari. Napoli, Da’ tipi del Guttenberg, 1836. Poema Albanese volto in italiano per Girolamo De Rada. Canti di Serafina Thopia, Principessa di Zadrima nel secolo XV*, Napoli, Dallo stabilimento tipografico di Domenico Capasso, 1843, 67 f.
- Poesie albanesi. Volume II. Uno specchio d’umano transito*, Napoli, Tipografia editrice F. di Gennaro e A Morano, 1898, 137 f.
- Santori, Francesco Antonio, *Sofia e Kominiatëve – Editio Princeps*, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino. Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku-Bruçi, Vol. I, Università degli Studi di Napoli L’Orientale, Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, Napoli, 2011.
- Sauku-Bruçi, Merita, “Vendi i munguar i Franqisk Anton Santorit në letërsinë shqipe (Franqisk Anton Santori’s rightful place in the Albanian literature) në ANAS, *Studia humanitatis*, 7-8, Shkup, Botim i Institutit ALB-SHKENCA, 2014, f. 29-42.
- Serembe, Giuseppe, *Vjershe*, a cura, con prefazione e note dell’avv. Cosmo Serembe, Milano, Società Tipografica italiana Grandi Edizioni, 1926 f.

[http://www.albanologia.unical.it/GirolamoDeRada/biblioteca\\_deradiana.html](http://www.albanologia.unical.it/GirolamoDeRada/biblioteca_deradiana.html).

<http://www.albanologia.unical.it/FrancescoAntonioSantori/opere.html>